

BACHELOR NË “INFERMIERI”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur teorik dhe praktik, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim kualifikimin dhe punësimin si infermier i përgjithshëm. Ky program studimi synon të përgatisë studentët që të ofrojnë një kujdes të sigurt, të efektshëm dhe të përqendruar te pacientët në mjedise të ndryshme të kujdesit shëndetësor, si dhe t'i edukojë ata mbi strategjitë për promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe edukimin shëndetësor në grupe të ndryshme të popullatës, duke punuar në bashkëpunim me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor për të optimizuar kujdesin ndaj pacientëve dhe për të përballuar sfidat e kujdesit shëndetësor.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të këtij programi, studenti është i aftë të:

- Aplikojë kujdesin e individualizuar bazuar në evidencat më të mira aktuale të fushës mjekësore, vlerat e pacientit dhe ekspertizën klinike.
- Zbatojë aftësitë e të menduarit kritik dhe të arsyetimit klinik për të vlerësuar nevojat e pacientit dhe për të zhvilluar ndërhyrjet e duhura në infermieri.
- Sigurojë ofrimin e një kujdesi infermior cilësor, të sigurt dhe efektiv të përqendruar te pacienti, në përmirësim të vazhdueshëm dhe bazuar në njohuritë e reja e protokollat e përditësuara të praktikës infermiore.
- Zhvillojë aftësitë për punë në ekip dhe aftësitë komunikuese me pacientët.
- Përdorë teknologjitë e informacionit shëndetësor, pajisjet e kujdesit ndaj pacientit dhe të komunikimit që mbështesin praktikën e sigurt dhe efektive të infermierisë.
- Implementojë plane bashkëkohore të asistencës infermiore për parandalimin klinik dhe promovimin e shëndetit, për të ofruar kujdes me në qendër pacientin gjatë gjithë jetës dhe në të gjithë vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Studentët që përfundojnë programin e studimit Bachelor në “Infermieri” mund të punësohen si:

- a. Infermier në Qendrat Shëndetësore/ Poliklinika
- b. Infermier në Spitalet rajonale dhe terciare
- c. Infermier në Institutin e Shëndetit Publik
- d. Infermier në Qendrat Rajonale të Epidemiologjisë & Depistimit
- e. Infermier në Kujdesin Paliativ
- f. Infermier në Shtëpitë e të Moshuarve
- g. Infermier në Kujdesin mjekësor në shtëpi
- h. Infermier në Shërbimet e Urgjencës
- i. Infermier në Qendrat e Transfuzionit të Gjakut

Mbajtësi i diplomës gëzon të drejtën të aplikojë për licensim, për ushtrimin e profesionit të rregulluar të infermierit, referuar kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



BACHELOR "INFERMIERI" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15-20%/31 ECTS

1	I	1	Biologji Humane	5
2	II	1	Hyrje në Psikologji	6
3	I	1	Shkrim Akademik + Metodat e kërkimit	8
4	I	1	Hyrje në Sociologji	6
5	I	2	Statistikë	6
				31

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/96 ECTS

1	I	1-2	Anatomi 1 + 2	10
2	I	2	Histologji dhe Anatomi patologjike e përgjithshme	6
3	II	1	Fiziologji	6
4	I	2	Bazat e Infermieristikës	6
5	II	2	Fiziologji patologjike	5
6	II	1	Principet e sëmundje të brendshme	6
7	II	2	Farmakologji	5
8	II	2	Sëmundje infektive dhe infermieristikë	5
9	II	1-2	Praktikë 1 -2	8
10	III	1	Obstetrikë- Gjinekologji dhe infermieristikë	5
11	II	2	Pediatri dhe infermieristikë	6
12	III	1	Kirurgji, Ortopedi, Traumatologji dhe infermieristikë	8
13	III	1-2	Praktikë 3-4	8
14	III	2	Neurologji, psikiatri dhe infermieristikë	6
15	III	1	Urgjenca, Anestezi-reanimacion dhe infermieristikë	6
				96

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/23 ECTS

1	II	2	Mjekësi laboratorike dhe Mikrobiologji	6
2	II	1	Deontologji, etikë dhe legjislacioni mjekësor	6
3	III	2	Shëndeti publik	6
4	I	2	Biokimi mjekësore	5
5	III	2	ORL, okulistikë dhe infermieristikë	6
6	II/III	1-2	Honors Course	6
				23

D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/23 ECTS

1	I	1	Terminologji mjekësore	4
2	I	1	Anglisht	5
3	III	1	Praktikë Klinike I	6
4	III	2	Praktikë Klinike II	8
				23

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm përfundimtar	7
---	-----	---	---	---

TOTALI 180